



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVATË

“ZYRA PËRMBARIMIT PRIVAT EGH” sh.p.k. Nipt M02202029D

Rruga “Vaso Pasha” Nr.13/1, Ap.1, Tirane E-mail: elvinth@hotmail.com Mob: +355682029920



Nr. 124 Dosje

Nr. 637 Prot.

Tiranë më datë 16/05/2022

URDHËR

(PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE
DUKE NDALUAR TJETERSIMIN E ADMINISTRATORIT)



Drejtuar : QËNDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Unë Elvin Gëzim Hoxha me detyrën e Përmbarduesit Gjyqësor Privat, pranë “Zyrës Përmbardimit Privat EGH” sh.p.k. në referim të Vendimit për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit Nr.Regj 293 datë 21.02.2022, i lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, për Titullin Ekzekutiv “Vendim Përfundimtar i Inspektimit” Nr.AKM-TR-2021-000011-5 Datë 24.06.2021, të Agjencia Rajonale Mjedisit Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbardimore Nr.124 datë 23.03.2022, kërkesën e kreditorit AGJENCIA KOMBETARE MJEDISIT për vënie në ekzekutim ndaj debitorit, Shoqëria “BIOPRODUCTS” sh.p.k., me Nr.NIPT L81826001A me administrator z.Bledar Daci.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr.367 Prot, Datë 23.03.2022 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban titulli ekzekutiv sëbashku me kamatëvonesat ligjore dhe tarifën e shërbimit përmbardimor, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se :

Debitori: Shoqëria “BIOPRODUCTS” sh.p.k., me Nr.NIPT L81826001A, ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi. Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorëve deri në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimi. Si në zbatim të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile dhe ligjit nr.26/2019 “Për Shërbimin Përmbardimor Gjyqësor Privat” si dhe Nenit 39 te Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010” Per Kundervajtjet Administrative”.

URDHEROJ :

QËNDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT të Vendos masën së sekuestros konservative në kuotat/aksionet e palës debitore Shoqëria “BIOPRODUCTS” sh.p.k., me Nr.NIPT L81826001A, mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre, mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat në regjistrin tregtar si dhe duke ndaluar tjetërsimin e administratorit të shoqërisë z.Bledar Daci

- Debitor : Shoqëria “BIOPRODUCTS” sh.p.k., me Nr.NIPT L81826001A me administrator z.Bledar Daci, me adresë: Rruga Abdi Bej Toptani, Godina nr.21, Valias, Kamëz, Tiranë.

Dokumentacioni do të qendrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga “Zyra Përmbardimit Privat EGH” sh.p.k. me Përmbardues Gjyqësor Elvin Hoxha.

Per veprimet apo mos veprimet tuaja duhet te na vini ne dijeni shkreserisht brenda afatit ligjor.

Personat qe behen pengese , do të pergjigjen në baze të nenit 606 K.Pr.Civile (paragrafi II) qe parashikon vendosjen e sanksionit te gjobes dhe kallezimit penal.

Ky urdher mbahet ne disa kopje dhe u njoftohet paleve te cilat kan te drejten e ankimit ne Gjykate brenda 5 (pese) diteve.

“ZYRA PËRMBARIMIT PRIVAT EGH” sh.p.k.

PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT

ELVIN HOXHA

